


Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa

Tremujori II, 2019

Tiranë, më 03 Shtator 2019: Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e dytë 2019 arriti 103,8, duke shënuar rritje me 0,3 %, në krahasim me tremujorin e dytë 2018.

Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, indeksi i grupit "Kosto të tjera" u rrit me 1,4 %, pasuar nga grupi "Shpenzime makinerie" me 0,9 % dhe "Shpenzime për paga" me 0,8 %. Rënie kanë shënuar grupet "Shpenzime transporti" me 0,6 % dhe "Shpenzime materiale" me 0,3 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa



Në tremujorin e dytë 2019 ndryshimi tremujor i indeksit të kushtimit në ndërtim shënoi rënie me 0,01 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, rënie kanë shënuar grupet "Kosto te tjera" me 1,0 %, "Shpenzime për paga" me 0,4 dhe "Shpenzime materiale" me 0,2 %. Rritje ka shënuar grupi "Shpenzime transporti" me 0,6 %.

Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa

Tremujori i parë 2011=100

%

Kodi	Grupet	Peshat	I-17	II-17	III-17	IV-17	I-18	II-18	III-18	IV-18	I-19	II-19
	Totali (1+2+3+4+5+6)	100,0	102,9	103,0	103,1	103,2	103,4	103,5	103,6	104,2	103,8	103,8
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	55,2	101,8	102,8	103,1	103,0	102,3	102,0	102,5	102,4	101,9	101,7
	a. Materiale ndërtimi	42,3	101,9	103,3	103,5	103,6	102,9	102,2	102,8	102,7	102,2	101,8
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	6,7	101,9	101,0	102,3	101,1	100,5	100,9	100,8	101,0	100,2	101,9
	c. Materiale hidro-sanitare	6,2	101,5	101,4	101,1	100,4	100,3	101,7	102,3	102,2	101,4	101,1
2	Shpenzime për paga	24,6	107,5	108,7	108,7	109,6	109,4	109,4	109,6	110,8	110,7	110,3
3	Shpenzime makinerie	8,3	102,5	102,8	102,8	102,8	102,3	102,5	102,6	103,4	103,4	103,4
4	Shpenzime transporti	5,3	97,8	97,8	97,8	98,0	99,9	100,1	100,2	99,9	98,9	99,5
5	Shpenzime për energji	2,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1	99,1
6	Kosto të tjera	4,5	110,9	109,6	109,3	110,8	113,0	112,1	111,6	114,5	114,8	113,6

Tab. 2. Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa

%

Kodi	Grupet	I-17/I-16	II-17/II-16	III-17/III-16	IV-17/IV-16	I-18/I-17	II-18/II-17	III-18/III-17	IV-18/IV-17	I-19/I-18	II-19/II-18
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,9	0,8	0,5	0,4	0,5	0,5	0,5	1,0	0,4	0,3
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	1,6	1,6	1,3	1,5	0,5	-0,8	-0,6	-0,5	-0,4	-0,3
	a. Materiale ndërtimi	1,5	2,0	1,7	2,2	1,0	-1,1	-0,7	-0,9	-0,7	-0,4
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	2,5	0,5	0,7	-0,5	-1,4	-0,1	-1,5	0,0	-0,3	1,0
	c. Materiale hidro-sanitare	1,6	0,7	-0,2	-1,1	-1,2	0,3	1,1	1,8	1,1	-0,6
2	Shpenzime për paga	1,7	2,5	1,6	2,4	1,7	0,6	0,9	1,1	1,3	0,8
3	Shpenzime makinerie	-0,3	-0,2	-0,3	-0,5	-0,2	-0,3	-0,2	0,6	1,0	0,9
4	Shpenzime transporti	-2,0	-1,5	-1,4	-1,9	2,1	2,3	2,5	1,9	-1,0	-0,6
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
6	Kosto të tjera	2,4	2,0	1,8	2,6	1,9	2,2	2,1	3,3	1,6	1,4

Tab. 3 . Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa

Kodi	Grupet	%									
		I-17/IV-16	II-17/II-17	III-17/II-17	IV-17/III-17	I-18/IV-17	II-18/I-18	III-18/II-18	IV-18/III-18	I-19/IV-18	II-19/I-19
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,2	0,1	0,1	0,1	0,2	0,1	0,1	0,6	-0,3	-0,01
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	0,4	1,0	0,2	-0,1	-0,6	-0,3	0,5	0,0	-0,5	-0,2
	a. Materiale ndërtimi	0,5	1,5	0,1	0,2	-0,7	-0,7	0,6	-0,1	-0,5	-0,4
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	0,4	-0,9	1,3	-1,2	-0,5	0,3	0,0	0,2	-0,8	1,6
	c. Materiale hidro-sanitare	0,1	-0,1	-0,3	-0,7	-0,1	1,4	0,5	-0,1	-0,7	-0,3
2	Shpenzime për paga	0,5	1,1	0,0	0,9	-0,2	0,0	0,2	1,1	-0,1	-0,4
3	Shpenzime makinerie	-0,8	0,3	0,0	0,0	-0,5	0,2	0,1	0,8	-0,1	0,0
4	Shpenzime transporti	-2,1	0,0	0,0	0,2	1,9	0,2	0,1	-0,3	-1,0	0,6
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
6	Kosto të tjera	2,6	-1,1	-0,3	1,4	2,0	-0,8	-0,4	2,5	0,3	-1,0

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjerë joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. IKN duke filluar nga tremujori i parë 2011 llogaritet me shportën e re të materialeve. Peshat e këtyre materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit. Tremujori i parë i vitit 2011 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i parë 2011=100). Shporta e re përbëhet nga 71 zëra nga të cilat 66 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mblidhen nga 165 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 65 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korent me tremujorin e mëparshëm.